



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-10977/20 datë:01.07.2020



Npi – 01/152 datë: 09.07.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2 (pika c) nenin 17 (pika s) dhe nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 10.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për Transparencë në Komuna Nr.04/2018; Si dhe Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna Nr.06/2018; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 09.07.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
DRAFT - RREGULLOREN PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE
PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSOR PËR FËMIJËT

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 09.07.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft - Rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës Komunal miqësor për fëmijët, në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj